

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Vetëllogaritja / *el-Muhaasebeh* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“O ju që keni besuar, kini frikë Allahun dhe le të shikojë secili çfarë ka përgatitur për të nesërmen.” (el-Hashr, 18)

Njeriu fillon detyrën e vetëllogaritjes vetëm pasi ta marrë vendimin për t’u penduar. Ky vendim ka tri shtylla:

- Krahasimi i favoreve të Allahut me shkeljet e tua. Dhe kjo është e vështirë për atë që i mungojnë tri cilësitë në vijim:
  - i. Drita e urtësisë<sup>1</sup>
  - ii. Dyshimi në vetveten<sup>2</sup>
  - iii. Të bërit dallim mes favoreve dhe sprovave<sup>3</sup>
- Dallimi mes asaj që i përket të Vërtetit (Zotit) dhe asaj që të përket ty apo vjen nga ti, në mënyrë që të kuptosh se shkelja që ti bën është një argument kundër teje, dëgjueshmëria jote është një favor ndaj teje, dhe caktimet e Zotit nuk janë justifikime për ty, por prova kundër teje.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Kjo është dija e dobishme, që zë vend në zemër pasi të përpunohet nga intelektin; është dija që të ndihmon ta dallosh të vërtetën nga e pavërteta; është dija që të ruan nga mosrespektimi i autoriteteve, por po ashtu të ruan të mos i dorëzohesh verbazi kujt do që s’është i pagabueshëm.

<sup>2</sup> Nëse ti ke mendim të mirë për vetveten (vetëpëlqim), s’do të këqyrësh t’i gjesh gabimet dhe shkeljet që ti bën.

<sup>3</sup> Për shembull, pasuria. Domethënë, a është pasuria favor, apo sprovë? Pasuria që një favor për Sulejmanin ﷺ dhe një sprovë për Karunin. Ki parasysh edhe pushtetin që i qe dhënë Faraonit dhe Dhul-Karnejnit.

<sup>4</sup> Autori po të paralajmëron që të mos justifikohesh me *kader*. *Kaderi* (caktimi) ndodh kundër teje, ngaqë ti e meriton kështu. Kjo vlen si për popujt, ashtu dhe për individët.

- Të dish se çdo akt dëgjueshmërie për të cilin ti pëlqen veten, është kundër teje<sup>5</sup>; çdo akt mosbindjeje (gjynah) për të cilin ti poshtëron vëllain tënd, do të jetë edhe yti.<sup>6</sup> Në fund, ti nuk bën të lësh peshoren e kohës sate të të dalë nga dora.<sup>7</sup>

---

Pa shfajësuar shkelësin për shkeljen e tij, mos fajëso dikë tjetër veç vetes sate për dështimet e tua.

<sup>5</sup> Nuk i ka hije një besimtari të mençur të sigurohet së tepërmi nga punët e mira që i bën, sepse nuk mund të jesh i sigurt se ato janë pranuar. Nëse ndihesh i sigurt se punët e mira të janë pranuar, kjo është shenjë e krekosjes dhe e vetëmashtrimit.

<sup>6</sup> Ngazëllimi për fatkeqësitë e të tjerëve është një nga cilësitë djallëzore. Bërja e gjynahut dhe largimi nga Allahu janë belatë më të mëdha që mund ta godasin njeriun.

<sup>7</sup> Kjo thekson rëndësinë e matjes së dobisë që ke grumbulluar dhe humbjes që ke pësuar në kohën tënde. Kjo të bën ta shfrytëzosh të tashmen dhe ta planifikosh të ardhmen në mënyrën më të mirë. Që të jesh në gjendje ta matësh përparimin tënd, duhet të kesh objektiva, strukturë, dhe rivlerësime të shpeshta.